Metoda sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku agjenti degëzues/shartues në fjalë është një agjent polimerik që përfshin pjesë të shumta F të lidhura në një shtyllë polimerike, F duke qënë një pjesë e pasaturuar e aftë për të reaguuar me radikale të lira, në mënyrë të preferuar e zgjedhur në mënyrë të pavarur nga -C=C- dhe C=O.

Metoda sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku agjenti degëzues/shartues polimerik në fjalë është një kopolimer i tipit A-B-A, ku çdonjëri prej A dhe B është zgjedhur në mënyrë të pavarur nga grupi i homo- dhe ose ko-polimerëve të stirenit (S), butadienit (B), izoprenit (I) dhe homologëve të tyre të hidrogjenizuar, ku në mënyrë të preferuar polimeri në fjalë është SBS (tribllok, stiren-butadien-stiren), SEBS (kopolimer tribllok linear i bazuar në stiren dhe etilen/butilen) ose SIS (stiren-izopren-stiren).

Metoda sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku hapi (iii) është kryer në prani të 0.1-20% wt agjent degëzues/shartues, në mënyrë të preferuar 0.5-10 wt%, në mënyrë më të preferuar 1-7 wt%.

Metoda sipas çdonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku hapat (ii) dhe (iii) janë kryer si një proces me një tenxhere, në mënyrë të preferuar në një ekstruder, në mënyrë më të preferuar ku është përdorur SEBS.

Përdorimi i një metode sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-14 në prodhimin e gomave, materialit për çati, materialit për dysheme, ose në ndërtimin e rrugëve.

(11) **11783**

(97) EP3561056/ 25.10.2023

(96) 17884396.7/ 21.12.2017

(22) 26.10.2023

(21) [AL/P/2023/527](#)

(54) **PEPTIDE PËR MJEKIMIN E DEGJENERIMIT MAKULAR TË LIDHUR ME MOSHËN**

11.01.2024

(30) JP 2016249020 22/12/2016

(71) Daiichi Sankyo Company, Limited/ 3-5-1, Nihonbashi Honcho, Chuo-ku, Tokyo 103-8426 JP

(72) Daisuke NISHIMIYA/c/o DAIICHI SANKYO COMPANY LIMITED, 3-5-1, Nihonbashi Honcho, Chuo-ku, Tokyo 103-8426 / JP,Ryuji HASHIMOTO/c/o Daiichi Sankyo Company, Limited

3-5-1, Nihonbashi Honcho

Chuo-ku

Tokyo 103-8426 / JP,Toshiyuki SATO/c/o Daiichi Sankyo Company, Limited

3-5-1, Nihonbashi Honcho

Chuo-ku

Tokyo 103-8426 / JP,Takako KIMURA/c/o Daiichi Sankyo RD Novare Co., Ltd.

1-16-13, Kitakasai

Edogawa-ku

Tokyo 134-8630 / JP,Atsushi YAMASAKI/c/o Daiichi Sankyo Company, Limited

3-5-1, Nihonbashi Honcho

Chuo-ku

Tokyo 103-8426 / JP,Tatsuya INOUE/c/o Daiichi Sankyo Company, Limited

3-5-1, Nihonbashi Honcho

Chuo-ku

Tokyo 103-8426 / JP,

(74) FATOS DEGA

NIKOLLA TUPE; Nd. 2; H. 4; Ap. 30; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË

(57) Një peptid mutant SPINK2 që frenon aktivitetin e proteazës së HTRA1 njerëzore, ku peptidi përfshin: (a) një sekuencë aminoacide të shfaqur në cilëndo nga SEQ ID NO: 24, 23, 25 deri në 27, 9, 15, 3, 5, 7, 11, 13, 17, 19, 21, 28 dhe 29 (Figurat 36 , 35, 37 deri në 39, 21, 27, 15, 17, 19, 23, 25, 29, 31, 33, 40 dhe 41) ; ose (b) një sekuencë aminoacide që rrjedh nga sequenca aminoacide e (a) nëpërmjet fshirjes nga 1 deri në 15 aminoacide.

Një polinukleotid që përmban një sekuencë nukleotide që kodon një sekuencë aminoacide të përfshirë në peptidin sipas pretendimit 1.

Një vektor që përfshin polinukleotidin sipas pretendimit 2.

Një qelizë që përfshin polinukleotidin sipas pretendimit 2, ose vektorin sipas pretendimit 3, ose që prodhon peptidin sipas pretendimit 1.

Një metodë për prodhimin e një peptidi mutant SPINK2 që frenon aktivitetin e proteazës së HTRA1, që përfshin hapat e mëposhtëm (i) dhe (ii) :

(i) kulturimi i qelizës sipas pretendimit 4; dhe

(ii) rikuperimi i peptidit mutant SPINK2 nga kultura.

Një konjugat që përmban peptidin sipas pretendimit 1, ose peptidin e prodhuar sipas pretendimit 5 të lidhur me një pjesë shtesë.

Konjugati sipas pretendimit 6 që është një polipeptid.

Metoda sipas pretendimit 5, ku rikuperimi i peptidit mutant SPINK2 përfshin një pastrim afiniteti duke përdorur një antitrop, ose fragment funksional të tij që lidhet me peptidin.

Një përbërje që përmban peptidin sipas pretendimit 1, peptidin e prodhuar sipas pretendimit 5, polinukleotidin sipas pretendimit 2, vektorin sipas pretendimit 3, qelizën sipas pretendimit 4 dhe/ose konjugatin sipas pretendimit 6 ose 7.

Një përbërje farmaceutike që përmban peptidin sipas pretendimit 1, peptidin e prodhuar sipas pretendimit 5, polinukleotidin sipas pretendimit 2, vektorin sipas pretendimit 3, qelizën sipas pretendimit 4 dhe/ose konjugatin sipas pretendimit 6 ose 7.

Përbërja farmaceutike sipas pretendimit 10, për përdorim në mjekimin ose parandalimin e një sëmundjeje të lidhur me HTRA1, ku sëmundja e lidhur me HTRA1 është një ose dy ose më shumë sëmundje të përzgjedhura nga grupi i përbërë nga degjenerimi makular i lagësht i lidhur me moshën, degjenerimi makular i thatë i lidhur me moshën, atrofia gjeografike, retinopatia diabetike, retinopatia e prematuritetit, vaskulopatia koroidale polipoidale, artriti reumatoid dhe osteoartriti.

Përbërja farmaceutike sipas pretendimit 10, ose përbërja farmaceutike për përdorim sipas pretendimit 11, që përmban një ose dy ose më shumë ilaçe shtesë.

Përbërja farmaceutike sipas pretendimit 10, ose përbërja farmaceutike për përdorim sipas pretendimit 11, që përdoret në kombinim me një ose dy ose më shumë ilaçe shtesë.

Përbërja farmaceutike sipas cilitdo prej pretendimeve 10, 12 ose 13, ose përbërja farmaceutike për përdorim sipas cilitdo prej pretendimeve 11 deri në 13, që është një agjent mbrojtës i retinës.

(11) **11785**

(97) EP3578792/ 27.09.2023

(96) 17714009.2/ 07.02.2017

(22) 26.10.2023

(21) [AL/P/2023/528](#)

(54) **METODA PËR RITJEN E EFIKASITETIT TË SISTEMEVE TË DJEGIES TË VAZHDUESHME**

11.01.2024

(30) PT 2017109894 03/02/2017

(71) Utis - Ultimate Technology to Industrial Savings, Lda/ Taguspark - Parque de Ciencia e Tecnologia, Núcleo Central, Sala 385, Oreiras, 2740-122 Porto Salvo PT

(72) QUINTÃO DUARTE SILVA, Francisco Diogo/Rua Marciano Tomás da Costa 24
Armazém 5;2739-510 Cacém;PT,DE MENESES MOUTINHO E HENRIQUES GONÇALO,
Paulo

Eduardo/Rua Marciano Tomás da Costa 24

Armazém 5;2739-510 Cacém;PT,MOURA BORDADO, João Carlos/DEQ Torre Sul
IST

Av. Rovisco Pais;1049-001 Lisboa;PT,

(74) Krenar Loloçi

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË

(57) Metoda për rritjen e efikasitetit të sistemeve me djegie të vazhdueshme, djegia duke qënë jo stoikiometrike dhe duke ndodhur në sistemin në fjalë të djegies së vazhdueshme, metodë që përfshin hapat e mëposhtëm: a. futjen e një sasive hidrogjeni, në raport me karburantin kryesor, ndërmjet 0.001 dhe 0.1% (v/V) të totalit të vëllimi të gazrave; b. futjen e hidrogjenit, futja në fjalë duke u bërë vazhdimisht ose në mënyrë të ndërprerë, në një ose më shumë pika hyrje në një dhomë të qitjes së vazhdueshme ku pikat e tilla të hyrjes janë: i. në transportin e karburantit ajror; ose ii. në pikat ku profili i temperaturës në gjendje thujse stacionare lejon ndezjen automatike të hidrogjenit; c. matjen e vazhdueshme të përmbajtjes së përbërjeve organike të avullueshme dhe monoksidit të karbonit në përzierjen e gazit të rrjedhshëm nga sistemi i djegies së vazhdueshme; d. kontrollin e futjes të hidrogjenit, kontrolli në fjalë i bërë në mënyrë kaskadë, duke u varur në përmbajtjen e përbërjeve organike të avullueshme dhe monoksidit të karbonit të matur.

Metoda sipas pretendimeve të mëparshme ku sistemi i djegies së vazhdueshme në fjalë është një furrë e vazhdueshme.

Metoda sipas pretendimeve të mëparshme ku futja e hidrogjenit bëhet në mënyrë të pandërprerë, në një ose më shumë pika hyrjeje nga dhoma e djegies së vazhdueshme, me anë të tubave të pajisur me valvulë mos-kthimi, si dhe një sistem furnizimi dhe ndërprerjeje të kontrolluar, në presione më të mëdha se presioni maksimal brenda dhomës së djegies.

Metoda sipas pretendimeve 2 dhe 3, ku profili i temperaturës është përcaktuar nga pirometra optikë, ose nga matja e temperaturës së sipërfaqes së jashtme të furrës së bashku me gjatësinë përkatëse dhe e derivuar nga llogaritja duke përfshirë përçueshmërinë dhe shpërndarjen e rrezatimit.

Metoda sipas pretendimit 2 dhe çdonjërit prej pretendimeve 3 ose 4, ku pikat hyrëse të hidrogjenit janë të vendosura përgjatë gjatësisë së një reaktori në distanca më të mëdha se rrezja e trupit të furrës (r) , por më pak se gjysma e gjatësisë së saj.

Metoda sipas pretendimit 2 dhe çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 5, ku pikat e hyrjes së hidrogjenit ndodhen përgjatë gjatësisë së një reaktori në distanca brenda rrezes së brendshme të trupit të furrës (r) ndërmjet 2r dhe 16r dhe ndërmjet 2r dhe 6r.

Metode sipas pretendimit 2 dhe çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 6, ku furra ka një seksion të drejtë eliptik, katror, drejtkëndësh ose trapezoidal dhe pikat e hyrjes së hidrogjenit janë të vendosura përgjatë gjatësisë së një reaktori në distanca më të mëdha se një rreze hidraulike.

(11) **11786**

(97) EP3728313/ 02.08.2023

(96) 18829861.6/ 21.12.2018

(22) 26.10.2023

(21) [AL/P/2023/529](#)

(54) **TERAPI E KOMBINUAR KUNDËR KANCERIT ME NJË ANTAGONIST IAP DHE NJË MOLECULE ANTI PD-1**

11.01.2024

(30) PCT/IB PCT/IB2017/001595 21/12/2017

(71) Debiopharm International S.A./ Forum "après-demain", Chemin Messidor 5-7, 1006 Lausanne CH

(72) VUAGNIAUX, Grégoire /Rue Orient-Ville 8;1005 Lausanne,CH;WIEDEMANN, Norbert/Avenue Fantaisie 6;1006 Lausanne,CH;GAVILLET, Bruno/430 route de Pitegny;01220 Grilly,FR;SZYLDERGERMAJN ALTMAN, Sergio Adrian/Chemin des Hirondelles 10;1162 Saint Prex,CH,

(74) Krenar Loloçi

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË

(57) Një frenues i një antagonistit të proteinës apoptoze (IAP) për përdorim në një metodë për trajtimin e kancerit në një subjekt human, metoda përfshin:

(i) administrimin e antagonistit IAP në një periudhë induktimi, ku kohëzgjatja e periudhës së induktimit është zgjedhur nga rangimi prej 1 deri në 48 ditë përpara administrimit të parë të një molekule anti-PD-1; ndjekur nga

(ii) administrimi i një molekule anti-PD-1 pas përfundimit të periudhës së induktimit; ku: molekula anti-PD-1 është Nivolumab, Pembrolizumab, Atezolizumab, Durvalumab, Avelumab, PDR001, IBI-308, Cemiplimab, Camrelizumab, BGB-A317, BCD-100, JS- 001, JNJ-3283, MEDI0680, AGEN-2034, TSR-042, Sym-021, PF-06801591, MGD-013, MGA-012, LZM-009, GLS-010, Genolimzumab, BI 754091, AK-104, CX072, WBP3155, SHR-1316, PD-L1 frenues milamolekular, BMS-936559, M-7824, LY- 3300054, KN-035, FAZ053, CK-301, ose CA-170; dhe antagonistit IAP i administruar gjatë periudhës së induksionit është Debio 1143, GDC-917/CUDC-427, LCL161, GDC-0152, TL-32711/Birinapant, HGS-1029/AEG-40826, BI 891065, ASTX-660 ose APG-1387, në mënyrë të preferueshme, antagonistit IAP është Debio 1143, LCL161 ose Birinapant.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 1, ku:

- (a) subjekti human është administruar me antagonistin IAP gjatë një periudhe induksioni prej 1 deri në 28 ditë, ndjekur nga administrimi i molekulës anti-PD-1;
- (b) subjekti human është administruar me antagonistin IAP gjatë një periudhe induksioni prej 5 deri në 28 ditë, ndjekur nga administrimi i molekulës anti-PD-1;
- (c) antagonistit IAP nuk është administruar në një ose më shumë ditë gjatë periudhës së induksioni; dhe/ose
- (d) administrimi i antagonistit IAP vazhdohet pasi administrimi me molekulën anti-PD-1 ka filluar, ose një tjetër antagonist IAP është administruar njëkohësisht me molekulën anti-PD-1.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 1 ose 2, ku:

- (a) kanceri është një kancer që është i njohur që përgjigjet ndaj trajtimit me një molekulë anti-PD-1 në 10% ose më shumë pacientë të trajtuar;
- (b) kanceri është kancer koke dhe qafe, melanoma, kanceri urotelial, kanceri i mushkërive me qeliza jo të vogla, tumoret e larta të paqëndrueshmërisë mikrosatelitore (MSI) nga vendi primar agnostik ose kanceri i veshkave;
- (c) kanceri është një kancer me një shkallë reagimi ndaj trajtimit me një molekulë anti-

PD-1 prej 10% ose më pak, mundësisht 5% ose më pak; ose

- (d) kanceri është kanceri i pankreasit, kanceri kolorektal, mieloma e shumëfishtë, kanceri i mushkërive me qeliza të vogla, hepatokarcinoma ose kanceri i vezores.

Antagonisti IAP për përdorim sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku kanceri është vlerësuar të jetë imunogjen i dobët.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 4, ku vlerësimi i sipërpërmendur konsiston në një analizë të një shënuesi të imunogjenitetit në kampionin biologjik të një pacienti të marrë përpara periudhës së induksionit dhe një konstatim se prania e shënuesit, niveli i shprehjes ose rezultati i prejardhur dështon në një prag të paracaktuar.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 5, ku:

- (a) shënuesi është PD-L1 i shprehur në qelizat e kancerit dhe/ose qelizat imune; ose
- (b) shënuesi është limfocite infiltruese të tumorit, mundësisht qelizat CD8+, ose barra e mutacionit të tumorit.

Antagonisti IAP për përdorim sipas çdo pretendimi të mëparshëm, ku administrimi i antagonistit IAP gjatë një periudhe induksioni vazhdon derisa kanceri të vlerësohet të jetë me imunogjenitet të lartë.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 7, ku vlerësimi i sipërpërmendur konsiston në një analizë të një shënuesi të imunogjenitetit në kampionin biologjik të një pacienti të marrë pas periudhës së induksionit dhe një konstatim se prania e shënuesit, niveli i shprehjes ose rezultati i prejardhur tejkalon një prag të paracaktuar.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 8, ku:

- (a) shënuesi është PD-L1 i shprehur në qelizat e kancerit dhe/ose qelizat imune; ose
- (b) shënuesi është limfocite infiltruese të tumorit, mundësisht qelizat CD8+, ose barra e mutacionit të tumorit.

Antagonisti IAP për përdorim sipas pretendimit 5, 6, 8 ose 9, ku mostra biologjike është një tumor ose biopsi e lëngshme.

Antagonisti IAP për përdorim sipas çdo pretendimi të mëparshëm, ku molekula anti-PD-1 është Nivolumab, Pembrolizumab, Atezolizumab, Durvalumab, Avelumab, PDR001, ose BI 754091.

Antagonisti IAP për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 10, ku molekula anti-PD-1 është një antittrup kundër PD-1 ose PD-L1.

Antagonisti IAP për përdorim sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku administrimi i molekulës anti-PD-1 kombinohet me një ose më shumë terapi të tjera kanceri, duke përfshirë një imunoterapi tjetër,

radioterapi, kimioterapi, kimioradioterapi, viruse onkolitike, terapi anti- angiogjene dhe/ose terapi të synuara të kancerit.

Antagonisti IAP për përdorim sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku antagonisti IAP është një aktivizues i dytë mimetik me prejardhje nga mitokondria i kaspazave (SMAC) .

Antagonisti IAP për përdorim sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku antagonisti IAP është Debio 1143.

(11) **11787**

(97) EP3430027/ 13.09.2023

(96) 17710904.8/ 15.03.2017

(22) 26.10.2023

(21) [AL/P/2023/530](#)

(54) **PEPTID PËR TU PËRDORUR NË IMUNOTERAPI KUNDËR KANCERIT TË MUSHKËRISË ME QELIZA JO TË VOGLA DHE KANCERIT TË MUSHKËRISË ME QELIZA TË VOGLA**

11.01.2024

(30) GB 201604458 16/03/2016 ,US 201662308944 P 16/03/2016

(71) Immatics Biotechnologies GmbH / Paul-Ehrlich-Strasse 15 72076 Tübingen DE

(72) MAHR, Andrea/Kirschenweg 22;72076 Tübingen,DE;Schoor, Oliver/Eichhaldenstrasse 19;72074 Tübingen,DE;Weinschenk, Toni/Im Morgenrain 15;73773 Aichwald,DE,

(74) Ela Panidha

Zhan D'Ark; Nd. 2; H. 3; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË

(57) 1. Një peptid që konsiston në sekuencën aminoacide të SEQ ID No. 1 (KVLEHVVRV) , ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme, për tu përdorur në trajtimin e kancer-it, ku kanceri i përmendur është përzgjedhur nga kanceri i mushkërisë me qeliza jo të vogla dhe kanceri i mushkërisë me qeliza të vogla.

Një receptor i qelizës-T, preferueshëm një rikombinues, receptor i tretshëm ose i qelizës-T me lidhje membranore që reagon me një ligand HLA, ku ligandi i përmendur konsiston në një peptid sipas pretendimit 1, për tu përdorur në trajtimin e kancerit të mushkërisë me qeliza jo të vogla ose të kancerit të mushkërisë me qeliza të vogla.

Një antitrop, veçanërisht një antitrop i tretshëm ose me lidhje membranore, i cili specifikisht njih peptidin sipas pretendimit 1 kur lidhet tek një molekulë MHC për tu përdorur në trajtimin e kancerit të mushkërisë me qeliza jo të vogla ose të kancerit të mushkërisë me qeliza të vogla.

Një përbërje farmaceutike që përmban të paktën një përbërës aktiv të përzgjedhur nga grupi që konsiston në peptidin sipas pretendimit 1, ose antitropin sipas pretendimit 3 ose receptorin e qelizës-T sipas pretendimit 2, dhe një transportues farmaceutikisht të pranueshëm, dhe opsionalisht eksipiente dhe/ose stabilizues shtesë farmaceutikisht të pranueshëm për tu përdorur në trajtimin e kancerit, ku kanceri i përmendur është përzgjedhur nga kanceri i mushkërisë me qeliza jo të vogla dhe kanceri i mushkërisë me qeliza të vogla.

(11) **11791**

(97) EP3596116/ 06.09.2023

(96) 18717149.1/ 13.03.2018

(22) 30.10.2023

(21) [AL/P/2023/537](#)

(54) **PROTEINA IMUNOMODULATORE TË PD-L1 VARIANT DHE PËRDORIMET E TYRE**

12.01.2024

(30) US 201762472554 P 16/03/2017 ,US 201762475076 P 22/03/2017 ,US 201762537923 P 27/07/2017 ,US 201762582249 P 06/11/2017

(71) Alpine Immune Sciences, Inc./ 188 East Blaine Street, Suite 200, Seattle, WA 98102 US

(72) Ryan SWANSON/201 Elliott Avenue West

Suite 230

Seattle, Washington 98119 / US,Michael KORNACKER/201 Elliott Avenue West

Suite 230

Seattle, Washington 98119 / US,Mark F. MAURER/201 Elliott Avenue West

Suite 230

Seattle, Washington 98119 / US,Dan ARDOUREL/201 Elliott Avenue West

Suite 230

Seattle, Washington 98119 / US,Daniel William DEMONTE/201 Elliott Avenue West

Suite 230

Seattle, Washington 98119 / US,Joseph L. KUIJPER/201 Elliott Avenue West

Suite 230

Seattle, Washington 98119 / US,

(74) Krenar Loloçi

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË

(57) Një polipeptid PD-L1 variant, që përfshin një domen IgV ose të dy një domen IgV dhe një domen IgC, ku polipeptidi PD-L1 variant përfshin një zëvendësim amino acid në një PD-L1 njerëzor të pamodifikuar që korrespondon me zëvendësimin amino acid N45D duke iu referuar numërimit të SEQ ID NO:30, ku polipeptidi PD-L1 variant lidhet në mënyrë specifike te ektodomeni i PD-1 me afinitet të rritur krahasuar me lidhjen e PD-L1 njerëzor të pamodifikuar te ektodomeni i PD-1; ku PD-L1 i pamodifikuar përfshin sekuencën e amino acideve të vendosur në SEQ ID NO:30 ose një pjesë e tyre që përfshin domenin IgV ose domenin IgV dhe domenin IgC; dhe ku polipeptidi PD-L1 variant përfshin një sekuencë të amino acideve që shpreh të paktën 85%, 86%, 87%, 88%, 89%, 90%, 91%, 92%, 93%, 94%, 95%, 96%, 97%, 98% ose 99% identitet të sekuencës me SEQ ID NO:30, 55, 309 ose 1728.

Polipeptidi PD-L1 variant i pretendimit 1, ku PD-L1 variant përfshin një ose më shumë zëvendësime amino acide të zgjedhura nga I20L/N45D, I36T/N45D, D43G/N45D, N45D/V58A, N45D/S75P, N45D/N78I, I20L/I36T/N45D, D43G/N45D/V58A, I20L/E27G/D43G/N45D/V58A/N78I, I20L/D43G/N45D/V58A/N78I, I20L/A33D/D43G/N45D/V58A/N78I, I20L/D43G/N45D/N78I, V11A/I20L/E27G/D43G/N45D/H51Y/S99G, I20L/K28E/D43G/N45D/V58A/Q89R, I20L/I36T/N45D, A33D/D43G/N45D/V58A/S75P, K23R/D43G/N45D,

D43G/N45D/L56Q/V58A/G101G-ins (G101GG) , I20L/K23E/D43G/N45D/V58A/N78I, I20L/K23E/D43G/N45D/V50A/N78I, I20L/K28E/D43G/N45D/V58A/Q89R/G101G-ins (G101GG) , N45D, N45D/K144E, N45D/P198S, N45D/P198T, N45D/R195G, N45D/R195S, N45D/S131F, N45D/V58D, N45D/I148V/R195G, N45D/K111T/R195G, N45D/N113Y/R195S, N45D/N165Y/E170G, N45D/Q89R/I98V, N45D/S131F/P198S, N45D/S75P/P198S, N45D/V50A/R195T, E27D/N45D/T183A/I188V, K23N/N45D/S75P/N120S, N45D/I148V/R195G/N201D, N45D/K111T/T183A/I188V, N45D/Q89R/F189S/P198S, N45D/T163I/K167R/R195G, N45D/V50A/I119T/K144E, T19A/N45D/K144E/R195G, V11E/N45D/T130A/P198T, V26A/N45D/T163I/T185A, K23N/N45D/L124S/K167T/R195G, K23N/N45D/Q73R/T163I, K28R/N45D/K57E/I98V/R195S, K28R/N45D/V129D/T163N/R195T, M41K/D43G/N45D/R64S/R195G, M41K/D43G/N45D/R64S/S99G, N45D/R68L/F173L/D197G/P198S, N45D/V50A/I148V/R195G/N201D, M41K/D43G/K44E/N45D/R195G/N201D, N45D/V50A/L124S/K144E/L179P/R195G.

Polipeptidi PD-L1 variant i pretendimit 1 ose pretendimit 2, ku:
polipeptidi PD-L1 variant përfshin domenin jashtëqelizor të PD-L1 (ECD) ; ose polipeptidi PD-L1 variant përfshin domenin IgV dhe domenin IgC; ose polipeptidi PD-L1 variant përfshin domenin IgV, opsionalisht ku domeni IgV ose fragmenti lidhës specifik i tij është pjesa e vetme PD-L1 e polipeptidit PD-L1 variant.

Polipeptidi PD-L1 variant i ndonjërit prej pretendimeve 1-3, ku polipeptidi PD-L1 variant përfshin sekuencën e amino acideve të vendosur në ndonjërin prej SEQ ID NOS: 66, 82, 101-104, 107, 109-110, 112-113, 115-117, 131, 147, 166-169, 172, 174-175, 177-178, 180-182, 254, 270, 289-292, 295, 297-298, 300-301, 303-305, 1725-1727, 1774-1780, 1785-1793, 1795, 1798-1800, 1802, 1804-1809, 1811-1818, 1863-1869, 1874-1882, 1884, 1887-1889, 1891, 1893-1898, 1900-1907, 1920-1922, 1935-1937, 1953, 1969, 1988-1991, 1994, 1996-1997, 1999-2000, 2002-2004, 2008 ose një fragment lidhës specifik të tyre , ose një sekuencë të amino acideve që shpreh të paktën 95% identitet të sekuencës me ndonjërin prej SEQ ID NOS: 66, 82, 101-104, 107, 109-110, 112-113, 115-117, 131, 147, 166-169, 172, 174-175, 177-178, 180-182, 254, 270, 289-292, 295, 297-298, 300-301, 303-305, 1725-1727, 1774-1780, 1785-1793, 1795, 1798-1800, 1802, 1804-1809, 1811-1818, 1863-1869, 1874-1882, 1884, 1887-1889, 1891, 1893-1898, 1900-1907, 1920-1922, 1935-1937, 1953, 1969, 1988-1991, 1994, 1996-1997, 1999-2000, 2002-2004, 2008.

Polipeptidi PD-L1 variant i ndonjërit prej pretendimeve 1-4, ku:
polipeptidi PD-L1 variant është një proteinë e tretshme, opsionalisht ku polipeptidi PD-L1 variant është lidhur te një domen multimerizimi.

Një proteinë bashkimi Fc imunomodulatore që përfshin polipeptidin PD-L1 variant të ndonjërit prej pretendimeve 1-5 të lidhur te një domen Fc ose një variant i tij me funksion efektor të reduktuar.

Polipeptidi PD-L1 variant i ndonjërit prej pretendimeve 1-5, që është një proteinë imunomodulatore transmembranore më tej që përfshin një domen transmembranor, opsionalisht ku domeni transmembranor është lidhur, direkt ose indirekt, te domeni jashtëqelizor (ECD) ose fragmenti lidhës specifik i tij i polipeptidit PD-L1 variant, opsionalisht ku polipeptidi PD-L1 më tej përfshin një domen sinjalizues citoplazmik.

Një proteinë imunomodulatore, që përfshin polipeptidin PD-L1 variant të ndonjërit prej pretendimeve 1-7 të lidhur, direkt ose indirekt nëpërmjet një lidhësi, te një polipeptid i dytë që përfshin një domen të superfamiljes së imunoglobulinave (IgSF) të një elementi të familjes IgSF; opsionalisht ku domeni IgSF është një domen me afinitet të modifikuar IgSF, domeni me afinitet

të modifikuar IgSF i sipërpërmendur që përfshin një ose më shumë modifikime të amino acideve krahasuar me domenin e pamodifikuar ose të tipit të egër IgSF të elementit të familjes IgSF dhe shpreh lidhje të ndryshuar të një ose më shumë prej partner(ëve) të tij lidhës të afërm krahasuar me domenin e pamodifikuar ose të tipit të egër IgSF.

Proteina imunomodulatore e pretendimit 8, ku proteina imunomodulatore më tej përfshin një domen multimerizimi të lidhur të paktën një prej polipeptidit PD-L1 variant, ose polipeptidi i dytë, opsionalisht ku domeni i multimerizimit është një domen Fc.

Një konjugat që është një proteinë bashkimi, që përfshin një polipeptid PD-L1 variant të ndonjërit prej pretendimeve 1-5, ose një proteinë imunomodulatore të ndonjërit prej pretendimeve 6, 8 dhe 9 të lidhur të një pjesë synuese që lidhet në mënyrë specifike të një molekulë në sipërfaqen e një qelize, opsionalisht ku qeliza është një qelizë immune ose një qelizë e një tumori, dhe opsionalisht ku pjesa është një antitrop ose fragment antigjen-lidhës.

. Një molekulë acidi nukleik, që kodon një polipeptid PD-L1 variant të ndonjërit prej pretendimeve 1-5, një proteinë imunomodulatore të ndonjërit prej pretendimeve 6, 8 dhe 9 ose konjugati që është një proteinë bashkimi e pretendimit 10.

Një vektor, që përfshin molekulën e acidit nukleik të pretendimit 11, opsionalisht ku vektori është një vektor shprehës.

Një kompozim farmaceutik, që përfshin polipeptidin PD-L1 variant të ndonjërit prej pretendimeve 1-7, një proteinë imunomodulatore të ndonjërit prej pretendimeve 6, 8 dhe 9, ose një konjugat i pretendimit 10, opsionalisht ku kompozimi farmaceutik përfshin një eksipient farmaceutikisht të pranueshëm

Një kompozim farmaceutik për përdorim në modulimin e një përgjigje immune në një subjekt, kompozimi farmaceutik që përfshin polipeptidin PD-L1 variant të ndonjërit prej pretendimeve 1-7, një proteinë imunomodulatore të ndonjërit prej pretendimeve 6, 8 dhe 9, ose një konjugat të pretendimit 10, opsionalisht ku kompozimi farmaceutik përfshin një eksipient farmaceutikisht të pranueshëm, ku modulimi i përgjigjes immune trajton një sëmundje ose gjendje në subjekt.

(11) **11795**

(97) EP3373996/ 02.08.2023

(96) 16865155.2/ 11.11.2016

(22) 31.10.2023

(21) [AL/P/2023/546](#)

(54) **METODA PËR GJENERIMIN, PËRDORIMIN DHE SHPËRNDARJEN E QELIZAVE STAMINALE TË AKTIVIZUARA**

15.01.2024

(30) US 201562254220 P 12/11/2015 ,US 201662321781 P 13/04/2016

(71) Ovokaitys, Todd F./ 2260 Rutherford Road, Carlsbad, CA 92008 US

(72) John, Scott STRACHAN/6 Marchhall Crescent, Edinburgh EH16 5HN / GB,Todd, Frank OVOKAITYS/6 Marchhall Crescent, Edinburgh EH16 5HN / US,

(74) Krenar Loloçi

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË

(57) Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim në një metodë riparimi indi të dëmtuar të pankreasit në trajtimin e një gjendje diabetike, që përfshin: përfitim të qelizave staminale të paaktivizuara; formimin e qelizave staminale të aktivizuara nga qelizat staminale të

paaktivizuara duke trajtuar qelizat staminale me një rreze lazer të zgjeruar, me fazë të konjuguar, me amplitudë të moduluar, ku rrezja lazer e zgjeruar, me fazë të konjuguar, me amplitudë të moduluar është formuar duke kaluar dritën lazer përmes një zgjeruesi rrezeje (530) , i tillë që drita lazer zgjerohet nga ndërmjet dy deri në dhjetë herë, dhe më pas përmes një pajisjeje për anulimin e fazës (550) dhe ku rrezja lazer e e zgjeruar, me fazë të konjuguar, me amplitudë të moduluar, përfshin një mori pulsesh me kohëzgjatje të shkurtër që kanë një gjatësi vale të paracaktuar dhe një amplitudë të paracaktuar; administrimin e qelizave staminale të aktivizuara në një trup që përmban indin biologjik; dhe aplikimin në mënyrë transkutane një rreze lazer koherente drejt objektivit përgjatë të paktën një aksi në mënyrë që rrezja lazer koherente drejt objektivit të bashkëveprojë me indin e dëmtuar në fjalë.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku rrezja lazer koherente drejt objektivit është gjeneruar duke përdorur një anulim faze 20% deri në 90%.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku janë mbledhur qelizat staminale të paaktivizuara nga një burim autolog duke përfshirë të paktën një prej gjakut periferik, palcës të kockave ose yndyrnave.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku janë mbledhur qelizat staminale të paaktivizuara nga një burim ekzogjen duke përfshirë të paktën një prej gjakut të kordonit dhe një placentë të pacientit.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, nga ku qelizat staminale të paaktivizuara kane rrjedhur një dhurues i qelizave staminale të përputhshëm gjenetiksht.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku gjatësia valore e paracaktuar është në një rang prej 405 deri në 980 nanometra.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku rrezja lazer e zgjeruar, me fazë të konjuguar, me amplitudë të moduluar ka një gjatësi vale prej 674 nanometra.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku rrezja lazer e zgjeruar, me fazë të konjuguar, me amplitudë të moduluar përfshin nga një varg të pulseve me kohëzgjatje të shkurtër të kohëzgjatjes nën-femto të dytë.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku, përpara trajtimit të qelizave staminale të paaktivizuara, drita lazer është kaluar përmes një Gjeneratori të nyjeve Strachan-Ovokaitys dhe ku Gjeneratori i nyjeve Strachan-Ovokaitys përfshin zgjeruesin e rrezes dhe pajisjen e anulimit të fazës.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku një anulim i fazës i rrezes lazer është rregulluar për të arritur një fuqi dalëse të paracaktuar para trajtimit të qelizave staminale të paaktivizuara.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku trajtimi i qelizave staminale të paaktivizuara përfshin aplikimin e rrezes lazer të zgjeruar, me faze të konjuguar, me amplitudë të moduluar në një kontenitor 510 që përmban qelizat staminale të paaktivizuara në mënyrë që kontenitori është rrotulluar dhe zhvendosur në mënyrë të njëkohëshme lart dhe poshtë në një drejtim vertikal gjatë procesit të aktivizimit.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku kontenitori është rrotulluar me një shpejtësi prej një rrotullimi në çdo 3 deri në 5 sekonda dhe është zhvendosur lart dhe poshtë për një kohëzgjatje prej 15 sekondash në çdo drejtim.

Qelizat staminale të aktivizuara për përdorim, sipas pretendimit 1, ku, në lidhje me qelizat staminale të paaktivizuara, qelizat staminale të aktivizuara përfshijnë të paktën një nga një rritje e shprehjes të një integrine alfa ose beta, një rritje në CD34, ose një veprim të zmadhuar migrues në një drejtim të rrezes koherente lazer drejt objektivit.

(11) **11797**

(97) EP4110078/ 06.09.2023

(96) 21708577.8/ 22.02.2021

(22) 01.11.2023

(21) [AL/P/2023/547](#)

(54) **FORMULIM USHQIMOR I EMULSIFIKUAR**

15.01.2024

(30) IT 202000004060 27/02/2020

(71) Barilla G. e R. Fratelli S.p.A./ Via Mantova, 166 43100 Parma IT

(72) CASSOTTA, Fabrizio/Via Codazzi, 15 26900 Lodi / IT, DE TATA, Vincenzo/Via G. Calestani, 3 43125 Parma / IT, IT; D'ALESSANDRO, Alessandro/Via Giuseppe Romita, 6 43123 Parma / IT,

(74) Ela Panidha

Zhan D'Ark; Nd. 2; H. 3; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË

(57) Nje formulim ushqimor i emulsifikuar gati për tu përdorur, i cili është pa aditivë që konsistojnë në mpikës, emulsifikues dhe stabilizues, që përfshin të paktën një perime të ndarë imët, vaj vegjetal, ujë dhe të paktën një farë vajore të ndarë imët. ku fara vajore në fjalë është e pranishme në një sas itë përfshirë midis 0.1% dhe 15% të peshës së peshës totale të formulimit, formulimi ushqimor i emulsifikuar në fjalë është përfutur nga homogjenizimi I kryer në një trysni të barabartë ose më të madhe se 10000kPa dhe që karakterizohet nga një diametër modal i grimcave që ndodhen në të më të lartë se ose të barabartë me 300µm dhe nga përmbajtja më tej e një fibre vegjetale të ndarë imët, që ka një përbërje fibre më të lartë se 70% w/v dhe një aftësi për tu lidhur me ujin më të lartë se 5g ujë/g material i thatë.

Formulim ushqimor sipas pretendimit 1, ku fibra vegjetale në fjalë e ndarë imët ka një përmbajtje lagështie më pak se 10%.

Formulim ushqimor sipas pretendimit 1 ose 2, ku përmbajtja e fibrës e fibrës vegjetale në fjalë ndodhet ndërmjet 75% dhe 80% w/v dhe aftësia për tu lidhur me ujin e fibrës vegje-tale në fjalë ndodhet ndërmjet 6.0 dhe 28.0g ujë/g material i thatë.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 3, ku diametri modal I grimcave të ndodhura në formulimin në fjalë ndodhet ndërmjet rreth 300 dhe 1500 mikrometra, preferueshëm ndërmjet 700 dhe 900 mikrometra.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 4, ku homogjenizimi në fjalë kryhet në një trysni të ndodhur ndërmjet 15000 kPa dhe 30000 kPa.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 5, ku të paktën një fibër vegje-tale e ndarë imët është zgjedhur nga grupi që përmban fibër agrumesh, fibër molle, fibër dardhe, fibër patateje, fibër karrote dhe fibër orizi, dhe ka një përmasë grimce mesatare të barabartë me ose më pak se 1500 µm.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 6, ku të paktën një farë vajore në formë të ndarë imët është zgjedhur nga grupi që përfshin bajame, arra kasius (shqeme), fistic, lajthi, arra, arra pekan, arra makadamia, stika, fara kërpi, fara luledielli, fara kungulli, fara liri, kikirikë, dhe fara kia, dhe ka një përmasë grimce mesatare të barabartë ose më të vogël se 1500µm.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 7, ku fibra vegjetale në fjalë është

fibër agrumesh, dhe fara vajore në fjalë është arra kasius.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 8, ku fibra vegjetale në fjalë është fibër molle, dhe fara vajore në fjalë është bajame.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 9, ku te paktën fibra vegjetale në fjalë e ndarë imët është zgjedhur nga grupi që përbëhet nga borzilok, majdanoz, trumzë, manxuranë dhe rigon dhe është preferueshëm borzilok.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimit 9, ku te paktën fibra vegjetale në fjalë e ndarë imët është e pranishme në një sasi ndërmjet 10% dhe 15% të peshës së peshës totale të formulimit dhe ka një përmasë grimce mesatare të barabartë ose me pak se 1500µm.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 11, ku vaji vegjetal në fjalë është zgjedhur nga vaj luledielli, vaj misri, vaj orizi, vaj susami, vaj kikiriku dhe vaj ulliri, preferueshëm vaj ulliri ekstra i virgjër, dhe është preferueshëm vaj luledielli.

Formulim ushqimor sipas pretendimit 12, ku vaji vegjetal në fjalë është I pranishëm në një sasi ndërmjet 10% dhe 15% të peshës së peshës totale të formulimit.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 13, që përmban më tej të paktën një përbërës të zgjedhur nga kripa, sheqernat, niseshtetë, proteinat vegjetale, bishtajorët, perimet e kopshtit, zarzavatet me gjethe, drithërat dhe aromatizuesit natyralë.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 14, që përmban më tej të paktën një përbërës acidifikues të zgjedhur nga grupi që përbëhet nga lëngje agrumesh dhe uthulla.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 15, që ka një viskozitet rota-cional më të madh sesa 80 Pa*s, preferueshëm më të madh sesa 115 Pa*s, në një temperaturë prej 22°C.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 16, karakterizuar nga një pH i ndodhur ndërmjet 3.0 dhe 5.0 preferueshëm ndërmjet 3.5 dhe 3.9.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 17, karakterizuar në atë që ka një vlerë të aktivitetit të ujit (aw) më të madh se ose të barabartë me 0.95, pre-ferueshëm të ndodhur ndërmjet 0.95 dhe 0.99.

Formulim ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 18, ku formulimi në fjalë është i ruajtshëm në një temperaturë që ndodhet ndërmjet 2°C dhe 30°C për një periudhë kohe prej të paktën dy javë, preferueshëm 24 muaj.

Përdorimi i një formulimi ushqimor sipas secilit nga pretendimet 1 deri në 19 si erëz.

(11) **11798**

(97) EP3670199/ 18.10.2023

(96) 19215141.3/ 11.12.2019

(22) 01.11.2023

(21) [AL/P/2023/548](#)

(54) **MAKINERI PRINTUESE ME BOJË DHE METODË PËR PRINTIMIN MBI PLLAKA**

15.01.2024

(30) IT 201800020215 19/12/2018

(71) KERAGLASS S.R.L./ Via Sassogattone, 13/A 42031 Baiso (RE) IT

(72) SPEZZANI, Stefano/4, Via Scaluccia 42031 BAISO (RE),IT,

(74) Ela Panidha

Zhan D'Ark; Nd. 2; H. 3; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË

(57) Një makineri printuese me bojë (10) për të printuar në pllaka (L) që përmban: - një mbështetëse (20) për të mbështetur një pllakë (L) ; - një grup mbyllës dhe qendërzuës (40) të konfiguruar për të kontaktuar pllakën (L) duke e mbyllur dhe qendëruar atë përkohësisht mbi mbështetësen (20) ; dhe - një pajisje printuese (30) të pajisur me të paktën një kokë printuese me bojë (31) e lëvizshme në raport me mbështetësen (20) përgjatë një drejtimi rrëshkitës (D) dhe e larguar nga ajo, ku koka printuese (31) është konfiguruar për të krijuar një dekorim në një sipërfaqe (L1) të pllakës (L) që pushon mbi mbështetëse (20) ; karakterizuar në atë që makineria printuese me bojë (10) përmban: - një grup matës (45) të konfiguruar për të matur të paktën një përmasë të pllakës (L) , ku grupi matës (45) është përcaktuar si pjesë përbërëse ose e ndërfutur e grupit mbyllës dhe qendërzuës (40, grupi matës (45) përmban të paktën një element sensor të konfiguruar për të gjetur dhe për të përcaktuar pozicionin e dy mureve vertikale të kundërta të pllakës (L) , si një matje e tërthortë ndërmjet dy ose më shumë elementeve të grupit mbyllës dhe qendërzuës (40) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 1, ku mbështetësja (20) përmban një plan pushues horizontal (A) i cili përmban një grup përparues për përparimin e pllakës mbështetëse (L) përgjatë një drejtimi përparues horizontal të paracaktuar (B) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 2, ku grupi përparues përmban një transportues me rul motorik (21) , ku rulat (210) të transportuesit me rul (21) përcak-tojnë tërësisht planin pushues (A) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 3, ku rulat (21) janë rula qeramike.

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 1, ku grupi mbyllës dhe qendërzuës (40) përmban të paktën një palë shina reciprokisht të lëvizshme mbi mbështetësen (20) dhe të konfiguruar për të kapur anash në mënyrë të lëshueshme një pllakë (L) të pozicionuar për pushim mbi mbështetësen (20) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 2, ku grupi mbyllës dhe qendërzuës (40) përmban të paktën një shinë ballore (43) të përshtatur për të ndaluar pllakën (L) që të përparojë përgjatë drejtimit të përparimit (B) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 1, ku pajisja printuese (30) përmban një grup kokash printuese (31) pranë njëra-tjetrës, të larguara dhe/ose të rreshtuara, sipas një drejtimi krah për krah (C) dhe reciprokisht e lëvizshme si njësi.

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 7, ku madhësia e grupit të kokave printuese (31) përgjatë drejtimit krah për krah (C) është të paktën e barabartë ose më e madhe se njëra anë e pllakës (L) që do të dekorohet.

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 2, ku drejtimi rrëshkitës (D) i kokës printuese (31) të pajisjes printuese (30) në mbështetësen (20) është horizontal dhe paralel me drejtimin e përparimit (B) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 2, ku drejtimi rrëshkitës (D) i kokës printuese (31) të pajisjes printuese (30) në mbështetësen (20) është horizontal dhe pingul me drejtimin përparues (B) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 1, ku pajisja printuese (30) përmban një pajisje ngrohëse (38) e cila është e lëvizshme në mbështetëse (20) dhe e larguar prej saj përgjatë drejtimit rrëshkitës (D) si një njësi me kokën printuese (31) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 11, ku pajisja ngrohëse (38) është rreshtuar me kokën printuese përgjatë një drejtimi rreshtues paralel me një drejtim rrëshkitës (D) dhe është pozicionuar lart ose poshtë kokës printuese (31) në një drejtim rrëshkitës të kokës printuese (31) përgjatë drejtimit rrëshkitës (B) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 11, ku pajisja ngrohëse (38) përmban të paktën një llampë infra të kuqe.

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 5, ku të paktën një element sensor i grupit matës (45) është konfiguruar për të përcaktuar gjerësinë e pllakës (L) nëpërmjet mat-jes së distancës së përbashkët ndërmjet shinave (41) kur shinat (41) kapin pllakën (L) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 14, ku elementi sensor përmban një trans-duktoz pozicioni të fiksuar tek njëra ose tek secila prej shinave (41) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 15, ku transduktori i pozicionit është konfiguruar për të përcaktuar një pozicion absolut të shinës përkatëse (41) .

Makineria printuese (10) sipas pretendimit 6, ku të paktën një element sensor i grupit matës (45) është konfiguruar të gjejë gjatësinë e pllakës (S) duke gjetur dhe matur një distancë ndërmjet shinës ballore (43) dhe një muri anësor të pasmë të pllakës (L) , kur shina ballore (43) ndalon pllakën (L) .

Një metodë printimi me bojë mbi pllaka (L) që përmban hapat e:

- mbështetjes së pllakës (L) mbi një mbështetëse (20) ;
- qendëzimin dhe një mbylljen e përkohshme të pllakës (L) mbi mbështetësen (20) nëpërmjet kontaktit me një grup mbyllës dhe qendëzues (40) i cili është i lëvizshëm në mbështetëse (20) ;
- matjen e të paktën një përmase në pllakën (L) nëpërmjet një grupi matës (45) të përcaktuar si pjesë përbërëse ose e ndërfutur e grupit mbyllës dhe qendëzues (40) dhe që përmban të paktën një element sensor të konfiguruar për të gjetur dhe për të përcaktuar pozicionin e dy mureve vertikale të kundërt të pllakës (L) , si një matje e tërthortë ndërmjet dy apo më shumë elementeve të grupit mbyllës dhe qendëzues (40) ; dhe
- krijimin e një dekorimi në një sipërfaqe (L1) të pllakës (L) , duke lëvizur një kokë të printerit me bojë (31) të një pajisjeje printuese në lidhje me pllakën (L) që qëndron në mbështetësen (20) dhe larg prej tij.

Metoda sipas pretendimit 18, ku matja e të paktën një përmase të pllakës (L) përmban përcaktimin e gjerësisë së pllakës (L) duke matur, me ndihmën e të përmendurit të paktën një sensor të grupit matës (45) , distancën e përbashkët ndërmjet një pale shinash (41) të grupit mbyllës dhe qendëzues (45) reciprokisht të lëvizshme mbi su-portin (20) dhe të konfiguruar për të kapur anash në mënyrë të lëshueshme një pllakë (L) të pozicionuar për pushim mbi mbështetësen (20) , kur shinat (41) kapin pllakën (L) .

Metoda sipas pretendimit 18, ku matja e të paktën një përmase të pllakës (L) përmban gjetjen, me anë të të përmendurit të paktën një sensor të grupit matës (45) , e gjatësisë së pllakës (S) duke gjetur dhe matur një distancë ndërmjet një shine ballore (43) të grupit mbyllës dhe qendëzues (40) të konfiguruar për të ndalur pllakën (L) nga përparimi përgjatë drejtimit përparues (B) dhe një mur anësor të pasmë të pllakës (L) , kur shina ballore (43) ndalon pllakën (L) .

(11) **11800**

(97) EP3363765/ 30.08.2023

(96) 18156056.6/ 09.02.2018

(22) 01.11.2023

(21) [AL/P/2023/549](#)

(54) **STABILIZUES PËR MAKINAT E PUNËS VETËLËVIZËSE**

15.01.2024

(30) IT 201700019360 21/02/2017

(71) Manitou Italia S.r.l./ Via Cristoforo Colombo 2, Localita' Cavazzona, 41013 Castelfranco Emilia (Modena) IT

(72) Marco IOTTI/Via Bedeschi 39, 42123 Reggio Emilia,IT,

(74) Krenar Loloçi

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË

(57) Një sistem stabilizues për një makinë pune vetëlëvizëse (1) si një mbajtës teleskopik ose të ngjashme, që përfshin një mori krahësh stabilizues (2) të aftë për t'u vendosur në tokë në mënyrë që të mundësojnë stabilizimin e makinës së përmendur (1) dhe duke përfshirë më tej: një ose më shumë pajisje matëse (6) të afta të zbulojnë një presion të cilit i nënshtrohen krahët e përmendur (2) dhe të prodhojnë sinjale presioni sipas presionit të zbuluar të përmendur; të paktën një njësi përpunimi e lidhur me pajisjet matëse të përmendur (6) dhe që përfshin një modul pozicioni të konfiguruar për të përcaktuar, bazuar në sinjalet e presionit të përmendur, nëse krahët (2) janë vendosur në tokë; dhe stabilizues me gërshërë (10) që përfshijnë dy palë krahë të përmendur (2) për stabilizim, secila prej të cilave është e rrotullueshme dhe që përfshijnë një sërë aktivizuesish (5) të përshtatshëm për përcaktimin e rrotullimit të krahëve stabilizues përkatës (2) dhe ngritjen e tyre makinë (1) ; ku çdo krah stabilizues (2) është teleskopik dhe përfshin të paktën një mëngë (21) , në të cilën një element i nxjerrë (22) që mban një pjesë (20) për t'u vendosur në tokë, futet në mënyrë të rrëshqitshme në mënyrë të konsiderueshme pa asnjë lojë, në mënyrë që të për të mundësuar zgjatjen ose tërheqjen e krahut (2) ; ku stabilizuesit e përmendur me gërshërë (10) janë të pajisur me një element mbështetës (3) , për çdo palë krahë (2) , elementi mbështetës i përmendur (3) është menduar për t'u fiksuar në makinën e punës (1) dhe në të cilën mënga (21) i çdo krahu (2) është i lidhur me anë të një menteshë të parë (41) , dhe ku një cilindër hidraulik (5) është i përfshirë në çdo aktivizues, cilindri (5) është i lidhur me anë të një menteshë të dytë (42) me elementi mbështetës i përmendur (3) dhe, me anë të një menteshë të tretë (43) në mëngën (21) të një krahu përkatës (2) ; karakterizuar në atë që të paktën një pajisje matës përfshin një kunj të parë ekstensometër (6) të përfshirë në menteshën e dytë (42) që lidh një cilindër hidraulik (5) dhe elementin mbështetës (3) .

Një sistem stabilizues për një makinë pune vetëlëvizëse (1) si një mbajtës teleskopik ose të ngjashme, që përfshin një mori krahësh stabilizues (2) të aftë për t'u vendosur në tokë në mënyrë që të mundësojnë stabilizimin e makinës së përmendur (1) dhe duke përfshirë më tej:

